



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.219/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët, Arsim Hamzaj kryesues, Kymete Kicaj dhe Skënder Çoçaj anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Shtime, e paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsisë në ditën e votimit, në Zgjedhjet Lokale 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 15.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

HEDHET e palejuar ankesa ZL.Anr.219/2025 e datës 14.10.2025 e parashtruar nga subjekti Partia Demokratike e Kosovës (PDK), e paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive në ditën e votimit për Zgjedhjet Lokale 2025, të mbajtura më datë 12.10.2025.

A r s y e t i m

Më datë 14.10.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën ZL.Anr.219/2025, të paraqitur nga subjekti Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, dega në Shtime, në të cilën pretendon se gjatë procesit zgjedhor për Kryetar të Komunës së Shtimes dhe Kuvendin Komunal (zgjedhjet e datës 12 tetor 2025), janë vërejtur parregullsi serioze që cenojnë integritetin e procesit dhe mund të kenë ndikuar drejtpërdrejt në rezultatin përfundimtar, si vijon: Rasti i Treni Bullgallgar në vendvotimin 2207/01 (fshati Belinc, Komuna e Shtimes) është gjetur një fletë-udhëzues për votim të përsëritur dhe mungon një fletëvotim origjinal për kryetarin e Komunës, çka tregon mundësinë e përdorimit të sistemit të organizuar të "Trenit Bullgar". Ky mekanizëm nënkupton që një votues hyn me një fletëvotim të plotësuar paraprakisht dhe del me fletën e paplotësuar për ta dorëzuar jashtë, duke e shfrytëzuar më pas në vendvotime të tjera. Raste të hapura nga Prokuroria Themelore lidhur me fotografimin e votës dhe kërcënimin e komisionerëve. Në disa vendvotime të tjera në Komunën e Shtimes psh (2201/06) është hapur rast ne Prokurorinë Themelore ne Ferizaj për fotografim i votës, presion ndaj votuesve dhe kërcënim ndaj komisionerëve të PDK-së, çka tregon veprime të koordinuara për deformim të vullnetit qytetar. Rezultati tepër i ngushtë për Kryetarin e Komunës (50,46%), i cili përjashton balotazhin me një diferencë minimale, ngrit dyshime serioze se parregullsitë e mësipërme

mund të kenë ndikuar në rezultatin përfundimtar. Sipas Ligjit për Zgjedhjet Lokale, zgjedhjet duhet të zhvillohen në frymën e lirisë, barazisë dhe fshehtësisë së votës, pa ndikim apo presion politik. Parregullsitë e përmendura (treni bullgar, mungesë fletëvotimi origjinal, kërcënime dhe fotografime të votës) cenojnë drejtpërdrejt parimin e fshehtësisë dhe integritetit të votës. Duke qenë se sistemi i "Trenit Bullgar" nuk kufizohet vetëm në një vendvotim, por mund të shfrytëzojë të njëjtin fletëvotim të nxjerrë nga një qendër për përdorim në qendra të tjera, dyshimi i bazuar shtrihet në tërë territorin e Komunës së Shtimes. Kjo gjendje e bën të pamundur të garantohet vullneti i lirë dhe real i votuesve dhe për pasojë nuk mund të certifikohet rezultati i zgjedhjeve pa u përsëritur votimi. Si dëshmi ka bashkangjitur kopjet e deklaratave të dy komisionerëve, Kopje e shënimit të librit të votimeve 2207/01 (fshati Belinc, komuna e Shtimes), Arikuj te mediave.

Në përgjigjen në ankesë KQZ thekson se pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të palës ankuese në lidhje me kërkesën e juaj, jep sqarimet/përgjigjet si rënë poshtë: Bazuar në nenin 6 të Rregullores Zgjedhore Nr. 12/2024 për Votimin, Numërimin në Vendvotim dhe Menaxhimin e Vendvotimit përcaktohet në mënyrë të detajuar mbarëvajtja dhe ecuria, obligimet në vendvotim. Gjithashtu, në bazë të nenit 101 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe Rregulloren Zgjedhore Nr-16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e numërimit në QKN. Gjatë procesit të verifikimit dhe numërimit vlejné procedurat e numërimit në VV, sipas Rregullores Zgjedhore Nr,12/2024 Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit. KQZ, pas pranimit të kërkesës së PZAP, menjëherë ka kontaktuar me KKZ e komunës së Shtimes, duke pranuar përgjigjet dhe sqarimet si në vijim: "Me datën 12.10.2025 rreth orës 23:00 në pranim të kutisë nga vendvotimi me numër 2207/01 kryesuesi na njofton se gjatë procesit të numërimit kanë vërejtur se në kutinë për kryetar komune ka qenë një mostër e fletëvotimit për asamble, nuk ka qenë fletëvotimi origjinal për kryetar komune. Ku bashkangjitur gjeni edhe dokumentet e skanuara të librit të votimit dhe deklaratën e kryesuesit të vendvotimit. Rasti menjëherë është lajmëruar në polici mirëpo nuk është ndërmarrë asnjë hap nga ana tyre. Me datë 14.10.2025 gjatë numërimit, në ndërrimin e dytë në orën rreth 16:30 përkatësisht në vendvotimin 2207/01, pas hapjes së kutisë së votimit ekipi e numërimit ka hasur në një fletëvotim fallco në zarfin numër 3 në kuti për kryetar. Ekipi e numërimit lajmëruan rastin tek KKZ, KKZ njofton rastin në polici, përgjigja e marrë nga policia është që nuk është në kompetencat e tyre. Ekipi i numërimit i QKN-së ka vazhduar me procedurat e numërimit ku gjatë numërimit të fletëvotimeve për kryetar komune dhe plotësimit të FRS Digjitale nuk janë përputhur të dhënat e numrit të fletëvotimeve ku mungon 1 fletëvotim i rregullt për kryetar komune. Të gjitha procedurat e numrit janë përfunduar sipas procedurës nga anëtarët e numërimit por te procesimi i të dhënave në platformën e KQZ , më saktësisht plotësimi i FRS Digjitale ka qenë e pamundur të procedohet më tutje pasi që të dhënat nuk përputheshin, arsyja 1 fletëvotim më pak. Kutia gjendet në QKN dhe të dhënat e kësaj kutie për arsyen më lartë nuk janë në platformën digjitale." (shih të bashkangjitur deklaratën e KKZ-së në Shtime). KQZ, ju njofton se i gjithë materiali zgjedhor duke përfshirë edhe kamerat e sigurisë, momentalisht gjendet në QKN të komunës së Shtimes, mirëpo pas përfundimit të gjithë procesit të punës së QKN i njëjti material zgjedhor dorëzohet nga QKN në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve - QNR, dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet e drejtësisë.

Bashkangjitur përgjigjes, janë: Njoftimin e KKZ-së në Shtime, Deklaratën e Kryesuesit të Vendvotimit, Librin e votimit, Librin e Evidencës në QKN, Mostrën e fletëvotimit Fallco.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

- **Ankesa është e palejuar**

Paneli vlerëson se pretendimi i palëve ankuese edhe pse i referohen parregullsive gjatë numërimit të votave, për shkak se përmes këtyre ankesave atakohet rezultati i cili është ende si rezultat preliminar, e i cili rezultat mund të ndryshoj, ankesa në këtë fazë të procesit zgjedhor është e parakohshme, për shkak se pas publikimit të rezultatit përfundimtar i njëjti rezultat është i ankimeshëm nga subjektet politike edhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numrin e votave të tyre. Meqenëse në aspektin kohor - faza e procesit zgjedhor kur parashtrohet ankesa është e parakohshme, ankesa duhet të hedhet poshtë si e palejueshme.

Në momentin e publikimit të rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 106.3 të Ligji Nr. 08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, *Personi fizik ose juridik, të drejtat ligjore të të cilit janë cenuar me vendimin e KQZ-së, sa i përket shpalljes së rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve, mund të parashtrojë ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga shpallja e tij.* Ankesa vendoset nga PZAP brenda nëntëdhjetë e gjashtë (96) orëve, nga parashtrimi i saj. Bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim të nenit 106.3 të LQP-së dhe Neni 13 paragrafi 6 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: *“në rastin kur pala ankuese paraqet ankesë për rezultatet preliminare të tabuluara nga KQZ, PZAP-i, me vendim e hedh si të palejuar ankesën”.*

Vendosja sikurse në dispozitiv të këtij vendimi për hedhjen e ankesës të palejueshme nuk e prejjudikon rezultatin përfundimtar, e po ashtu me të njëjtat pretendime ankimore palët mund ta atakojnë rezultatin përfundimtar. Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LQP-së dhe neni 13 paragrafi 6 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës
ZL.Anr.219/2025 më datën 15.10.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LQP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.